

20091142168

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKES SË MAQEDONISE ME HUA TE BANKA
KREDITORE PËR RINDERTIM-KFV SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR
PROJEKTIN “UJESJELLES DHE KANALIZIM TË KOMUNAVE FAZA I”

Neni 1

Republika e Maqedonise ngarkohet te Banka Kreditore për Rindertim - KFV nga Republika Federale e Gjermanise me hua në shume prej 8.635.000 EURO, dedikuar për realizimin e projektit “Ujesjelles dhe kanalizim të komunave faza I”.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshjen për hua për projektin “Ujesjelles dhe kanalizim të komunave faza I, që do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise dhe Bankes Kreditore për Rindertim-KFV.

Në emer të Republikes së Maqedonise, Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni do ta nenshkruaje ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagesen e huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 30 vjet, me grejs periodhe të lidhur prej 10 vjetesh.

Shkalla vjetore e kamates eshte shkalle fikse e kamates dhe e njehta eshte 2%.

Huaja do të paguhet në dy keste gjysmevjetore që arrijne për pagese më 30 qershor dhe 30 dhjetor çdo vit, duke filluar prej 30 dhjetorit 2019, e duke mbaruar më 30 dhjetor 2039.

Neni 4

Për shumen e mjeteve të paterhequra nga huaja i paguhet provizion Bankes Kreditore për Rindertim–KFV në shume prej 0,25% nga shuma e huas në nivel vjetor.

Provizionin nga paragrafi 1 i ketij neni paguhet në gjysmevjetor edhe atë më 30 qershor dhe 30 dhjetor çdo vit.

Për shumen e huas e cila nuk duhet të paguhet në afatet e parapara, do t’i paguhet kamatevonesë në lartesi të shkalles së kamates baze Bankes Qendrore të RF të Gjermanise, e rritur për 3% në vit.

Neni 5

Shfrytezues të mjeteve të huas nga neni 1 të ketij ligji jane komunat dhe ndermarrjet publike komunale të themeluara nga komunat, që i plotesojne kushtet ngarkim me hua në pajtim me Ligjin për borxh publik dhe Ligjin për financim të njesive të vetadministrimit lokal.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe të obligimeve ndermjet Republikes së Maqedonise dhe shfrytezuesve të mjeteve të huazuara nga neni 5 të ketij ligji, Ministria e Financave do të lidhe marreveshje të vecanta për hua.

Neni 7

Republika e Maqedonise, huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga mjetet që do të grumbullohen me pagesen e mjeteve të huazuara nga shfrytezuesit e mjeteve të huas nga neni 5 të ketij ligji në pajtim me marreveshjet e vecanta për hua nga neni 6 i ketij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në „Gazeten zyrtare të Republikes Maqedonise“.